

Vendim nr. 127 datë 13.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 13.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 2 (R) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: ROVENA GASHI

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 12, datë 29.05.2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 71/c i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Roven Gashi ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme, për rrjedhojë ajo i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 84/2016*).

2. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kërkuesja është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 48, datë 25.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), me arsyetimin se, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 59, pika 1, shkronja “a” dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

3. Mbi bazën e ankimit të kërkueses, Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), me vendimin nr. 12, datë 29.05.2019 (*vendimi nr. 12/2019*), ka lënë në fuqi vendimin e KPK-së. KPA-ja ka arsyetuar se kërkuesja ka në pronësi pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht; deklarimi për këto pasuri është kryer në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë; nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, si dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016. Ky vendim është disponuar njëzëri nga trupi gjykues i KPA-së, ku në përbërje të tij ka qenë edhe anëtari L.D., në cilësinë e relatorit të çështjes.

4. Pas dhënies së këtij vendimi, anëtari i KPA-së L.D. është proceduar penalisht për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë, i Kodit Penal (KP), për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë nr. 5, datë 08.03.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO e Apelit). Në rishqyrtimin e rekursit të kërkuesit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2023-406 (76), datë 21.03.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të GJKKO-së së Apelit, me arsyetimin se në rastin konkret plotësohen të gjitha elementet e veprës penale të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë, i KP-së dhe shkaqet e rekursit nuk janë të tilla që mund të ndryshojnë vendimmarrjen e kundërshtuar.

5. Ndërkohë, në datën 04.10.2022, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), ka disponuar me vendim për çështjen *Besnik Cani kundër Shqipërisë* (aplikimi nr. 37474/20), për kundërshtimin e shkarkimit të tij nga detyra si rezultat i procesit të rivlerësimit, ku ka gjetur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtën e ankuesit për një “gjykatë të krijuar me ligj”. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se “*ekzistonte një pretendim i argumentueshëm për një shkelje të qartë të rregullit themelor të ligjit vendas, i cili ka ndikuar në mënyrë të pafavorshme në emërimin e L.D. si gjyqtar i KPA-së. Për sa më sipër dhe duke pasur në konsideratë veçanërisht faktin se gjykatat vendase nuk trajtuan në mënyrën e duhur pyetjet e ngritura nga ankuesi në lidhje me Konventën, Gjykata arrin në përfundimin se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës, për shkak se L.D. ishte pjesë e trupës gjyqësore të KPA-së, e cila shqyrtoi çështjen e ankuesit*” (shih paragrafët 115 dhe 116 të vendimit të GJEDNJ-së).

6. Në datën 24.04.2023 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të KPA-së. Po kështu, në datën 25.05.2023 ajo i është drejtuar sërish Gjykatës me plotësim kërkesë, bashkëlidhur së cilës ka paraqitur vendimin nr. 00-2023-406 (76), datë 21.03.2023 të Gjykatës së Lartë.

II

Pretendimet e kërkuases

7. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të KPA-së, duke pretenduar se:

- 7.1. Gjykata ka juridiksion për rishikimin e vendimit nr. 12/2019 të KPA-së, si gjykata më e lartë që garanton respektimin e procesit të rregullt ligjor. Vendimi gjyqësor i formës së prerë për dënimin e anëtarit/relator në KPA për çështjen e saj përbën një provë të re që nuk mund të dihej prej saj gjatë shqyrtimit të ankimit në atë gjykatë. Kërkesa ka për qëllim korrigjimin e pasojave të shkeljes së të drejtës së brendshme gjatë procesit të emërimit të anëtarit L.D., të lidhur me të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.
- 7.2. *Cenimin e procesit të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi ankimi i saj në KPA është gjykuar në mungesë të legjitimitetit të kërkuar nga Kushtetuta dhe ligji. Anëtari që ka dhënë vendimin nuk është zgjedhur në bazë të meritës, nuk ka qenë bartës i aftësive profesionale, kompetencës teknike dhe integritetit moral të domosdoshëm për të garantuar gjykatën e caktuar me ligj dhe pavarësinë personale për të dhënë drejtësi në çështjen e saj duke dhënë një vendim të padrejtë. Kjo situatë ka sjellë për pasojë edhe *cenimin e parimit të sigurisë juridike në shtetin e së drejtës*.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

8. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Kjo

kompetencë kushtetuese e Gjykatës është reflektuar dhe detajuar në nenin 71 të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës çdo akt që cenon këto të drejta dhe liri, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji. Në këndvështrim të kësaj kompetence, Gjykata vlerëson kërkesat e individit kur ai pretendon se të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese janë cenuar nga një akt i pushtetit publik ose vendim gjyqësor.

9. Kolegji vëren se, referuar përmbajtjes së nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare, Gjykata Kushtetuese funksionon me dy kolegje. Neni F, pika 1, i Aneksit të Kushtetutës parashikon se KPA-ja është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të KPK-së, sipas Aneksit dhe ligjit. Kurse juridiksioni i Gjykatës në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për kontrollin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit është i kufizuar nga juridiksioni që dispozitat e Kushtetutës dhe Aneksit të saj u kanë dhënë organeve të rivlerësimit (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, organet e rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ai konsiderohet si një juridiksion i posaçëm, i cili u jep garanci gjyqësore personave të prekur nga procedura e rivlerësimit dhe të drejtat dhe garancitë e përfshira në skemën legislative dhe kushtetuese duket se janë mjaft të gjera (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Neni 179/b, pika 2, i Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit. Në këtë kuptim, të gjitha të drejtat procedurale kushtetuese, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës, përfshirë edhe standardin e “gjykatës së krijuar me ligj”, Kushtetuta ua ka garantuar subjekteve të rivlerësimit, përmes procesit gjyqësor në KPA. Duke pasur parasysh kompetencat e KPA-së, si organi që kontrollon vendimmarrjen e KPK-së, Gjykata ka vlerësuar se ky proces kontrollohet edhe nga pikëpamja e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 2, datë 18.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për sa më lart, si edhe në përputhje me qëndrimin që Gjykata ka mbajtur tashmë në shqyrtimin e kërkesave që kundërshtojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, juridiksioni i saj në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual për këto çështje është i kufizuar nga vetë Kushtetuta, ndaj pretendimet që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e këtyre organeve, qofshin të natyrës

kushtetuese, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt në drejtim të gjykatës së caktuar me ligj dhe sigurisë juridike, nuk mund të jenë objekt shqyrtimi në këtë Gjykatë. Subjektet e rivlerësimit nuk legjitimohen t'i drejtohen Gjykatës, nëpërmjet ankimit kushtetues individual, për pretendime ose kërkesa që i përkasin atij procesi, i cili, siç vlerëson edhe GJEDNJ-ja, ka natyrë përfundimtare brenda sistemit të brendshëm të ankimeve.

13. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kjo çështje nuk hyn në juridiksionin kushtetues për sa kohë që objekt i kërimit është rishikimi i vendimit të një organi tjetër kushtetues, KPA-së. Kolegji thekson se juridiksioni i kësaj Gjykate përcaktohet nga Kushtetuta, ndaj vlerëson se nuk mund të pranohet përfshirja në juridiksionin e saj i kërkesës së kërkueses.

14. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kjo çështje nuk hyn në juridiksionin kushtetues, ndaj kërkesa nuk duhet të pranohet për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.